



Letër përshëndetëse Klubit “Afrim Zhitia”, me rastin e festimit të 100 vjetorit të ditëlindjes së gjeniut, Enver Hoxha!

- Pjesëmarrësve, të cilët i bashkoi e vërteta e madhe: ENVER HOXHA PËR KOSOVËN!

Të nderuar atdhetarë dhe atdhetare,

Ju përshëndesim me zemra të zjarrta prej së largu nga afër, me përshëndetjen revolucionare, ashtu siç na përshëndeste gjeniu ynë i madh, ENVER SHQIPTARI!

Me kënaqësi e morëm kumtin e shumëpritur se ju keni vendosur ta festoni 100 vjetorin e lindjes së udhëheqësit, strategut ushtarak edhe diplomatit të madh të kombit shqiptar - Enver Hoxhës.

Kënaqësia jonë që më e madhe dhe tejet e ligjshme, kur e morëm vesh se vëllezërit dhe motrat tona të idealeve, këtë përvjetorë të madhërishëm do ta bëjnë në kryeqytetin e Kosovës heroike në Prishtinë, për të cilën Enveri ynë bëri aq shumë, për t'ia dhënë dritën e diturisë, udhëzimet për punë dhe luftë lundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët të ndihmuar nga qarqet reaksionare në botë; për më tepër se 100 vjet i ndanë trojet shqiptare, padrejtësisht, nga gjiri i Mëmës Shqipëri!

Për këtë nder të madh, që ju i bëni ditëlindjes së Atij burri të madh të kombit, merita të veçanta kanë organizatorët e këtij manifestimi, Klubi “Afrim Zhitia”, për të cilët kemi konsiderata më të larta dhe ju shprehim përkrahjen tonë të sinqertë dhe të pakursyer. Kurdoherë do të jemi me ju, që të japim sadopak kontributin tonë modest në përkrahje të veprimtarisë suaj atdhetare dhe revolucionare!

I përshëndesim pastaj me ngrohtësi të veçantë vëllazërore shokët dhe shoqet nga të gjitha viset tjera të Shqipërisë Natyrale, nga jugu në veri, nga lindja në perëndim!

Me këtë rast na lejoni të nderuar bashkatdhetarë - që t'jua përkujtojmë një këngë atdhetare të motrës sonë tropojane, të famshmes Fatime Sokoli, e cila për Gjeniuin - Enver Hoxha, këndonte:

”...Emrin tënd e kemi në flamur, njëherë ke lindë dhe nuk vdes kurrë”!

**RROFTË SHQIPËRIA NATYRALE!
RROFTË KOMBI SHQIPTAR!
LAVDI VEPRËS SË ENVER HOXHËS!**

Vëllezërit tuaj të idealeve në mërgim:

1. Ramadan Pllana, veprimtar i çështjes kombëtare, ish i burgosur politik, Zvicër,
2. Xhemil Zeqiri, veprimtar i çështjes kombëtare, analist, Danimarkë,
3. Ramadan Kurti, veprimtar i çështjes kombëtare, Suedi,
4. Zeqir Duraku, veprimtar i çështjes kombëtare, poet, Suedi,
5. Fadil Shyti, veprimtar i çështjes kombëtare, poet dhe analist, Suedi,
6. Azem Musliu, veprimtar i çështjes kombëtare, ish-ushtar i UÇK-së, Kanada,
7. Nisret Ahmeti, veprimtar i çështjes kombëtare, analist, Gjermani dhe
8. Beqir Elshani, veprimtar i çështjes kombëtare, shkrimtar, Suedi.

6 tetor 2008